**U D H Ë Z I M**
**Nr.1, datë 9.5.2003**

**PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.159, DATË 13.3.2003 "PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE QË PRIVATIZOHET, SI DHE PROCEDURA E SHITJES"**

*(Ndryshuar me udhëzimin nr. 68, datë 15.3.2005; nr. 1, datë 9.5.2005)*
*(i përditësuar)*

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.159, datë 13.3.2003 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet, si dhe procedura e shitjes", Ministria e Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit nxjerrin këtë

U D H Ë Z I M:

1. Të gjitha miratimet e privatizimit, para hyrjes në fuqi të vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.159, datë 13.3.2003 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet dhe procedurat e shitjes", si dhe ngritja e komisioneve të vlerësimit dhe miratimi i ekspertëve në zbatim të tyre, do të konsiderohen të vlefshme, por përgatitja e dokumentacionit të vlerësimit dhe procedurat e shitjes do të bëhen në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.159, datë 13.3.2003.

*0.1 Miratimi i kalimit të pronës shtetërore në pronë private drejtohet dhe organizohet nga Ministri i Ekonomisë. Përjashtimisht, miratimi i kalimit të pronës shtetërore në pronë private për pasuritë e luajtshme kryhet nga organi që i administron ato.*

*0.2 Përkufizime*

*1. "Pasuritë e luajtshme" do të konsiderohen: makineritë, pajisjet, inventari ekonomik dhe mjetet e xhiros, por jo linjat e prodhimit dhe të shërbimit, si dhe aksesorët që bëjnë të pamundur funksionimin e këtyre linjave.*

*2. "Organi që i administron ato" do të konsiderohen:*

*a) Për organet e qeverisjes vendore, konsiderohet: këshilli i qarkut, i bashkisë dhe i komunës;*

*b) Për institucionet qendrore, konsiderohet: titullari i institucionit qendror.*

*c) Për ndërmarrjet shtetërore të patransformuara, konsiderohet: këshilli drejtues i ndërmarrjes dhe kur nuk ka të tillë, miratimi i kalimit të pronës shtetërore në pronë private bëhet nga titullari i ministrisë së vartësisë administrative.*

*d) Për shoqëritë tregtare, konsiderohet: këshilli mbikëqyrës.*

*e) Për repartet ushtarake dhe komisariatet e policisë, konsiderohet: titullari i ministrisë përkatëse.*

2. Te kapitulli i I-rë pika 4 për vlerësimin e mjeteve të transportit tokësor dhe detar, të blera ose të vëna në shfrytëzim pas vitit të liberalizimit të çmimeve (1 korrik 1992), shprehja "… pa zbatuar indeksin e çmimit …" të kuptohet "… raportin e indeksit …".

3. Në kapitullin e I-rë pika 12 për vlerësimin e objekteve, makinerive dhe pajisjeve etj. të shoqërive tregtare, si vlerë fillestare sipas kontabilitetit do të konsiderohet vlera e përcaktuar në dokumentacionin e transformimit në shoqëri anonime e regjistruar në gjykatë (në regjistrin tregtar).

4. Për rastet kur në ankandin për shitjen e objekteve ose aseteve me vlerë fillestare, me VAM të ulur me rezervë dhe me zarfa të mbyllur paraqitet vetëm një kërkesë përpara komisionit të ankandit; komisioni duhet ta evidentojë këtë kërkesë në procesverbalin e ankandit dhe objekti t'i nënshtrohet procedurës së ripublikimit sipas pikës 9 kapitulli i III-të i këtij vendimi.

5. Për zbatim të pikës 2 paragrafi i I-rë për rastet e shitjes së objekteve me pronar trualli,

me mbërritjen e dokumentacionit të privatizimit pranë AKP-së Tiranë, kjo e fundit afishon njoftimin në ambientet e ndërmarrjes që e administron atë. Ish-pronari i truallit që dëshiron të blejë objektin duhet të paraqitet pranë AKP-së Tiranë, brenda një afati 20 ditor nga dita e publikimit (afishimit), duke depozituar kërkesën me shkrim në të cilën shprehet se dëshiron të blejë objektin në fjalë, dokumentacionin që vërteton pagesën prej 20 për qind të vlerës së pronës që kërkon të blejë dhe vendimin përkatës të komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve, të noterizuar, i cili përcakton se ai është pronar i tokës.

*Për verifikimin e dokumentacionit të pronësisë së paraqitur nga ish-pronari i truallit, që do të blejë objektin dhe legjitimitetin e tij si të tillë, ngrihet një komision nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, në përbërje të të cilit duhet të jetë dhe një përfaqësues i Ministrisë së Ekonomisë.*

6. Në rast se brenda këtij afati kohor ish-pronari nuk paraqitet, AKP-ja nxjerr objektin në publikim. Në qoftë se ditën e zhvillimit të ankandit paraqitet edhe pronari i truallit, me dokumentet përkatëse të pronësisë, komisioni i ankandit, pas vlerësimit të dokumentacionit në fjalë shpall fitues ankandi pronarin e truallit, pa konkurrim. Për rastet kur komisioni i ankandit ka vështirësi në vlerësimin e dokumentacionit të pronësisë së paraqitur nga pronari i truallit, atëherë komisioni i ankandit cakton një datë tjetër për zhvillimin e tij brenda 5 ditëve nga data e zhvillimit të ankandit, me qëllim që të vlerësojë dokumentacionin e pronësisë.

7. Në zbatim të pikës 3 kapitulli i III-të me mbërritjen e dokumentacionit të privatizimit për shitjen e makinerive, automjeteve, pajisjeve dhe mjeteve të punës, degët e AKP-ve në prefektura njoftojnë me shkrim AKP-në në qendër, nga e cila marrin konformimin për fillimin e procedurave të shitjes. Pas marrjes së konfirmimit degët e AKP-ve afishojnë njoftimin në ambientet e saj dhe të ndërmarrjes që i ka në administrim ato. Punonjësit që i kanë ose i kanë pasur në përdorim makineritë, automjetet, pajisjet ose mjetet e punës dhe dëshirojnë t'i blejnë, duhet të paraqesin pranë degës së AKP-së brenda afatit 20 ditor të afishimit kërkesën me shkrim dhe dokumentacionin që vërteton pagesën prej 20 për qind të vleftës së pronës që kërkojnë të blejnë. Dosja e privatizimit duhet të përmbajë edhe vërtetimin për punonjësit që i kanë ose i kanë pasur në përdorim këto asete.

8. Në rast se punonjësit që i kanë pasur ose i kanë në përdorim mjetet nuk paraqesin kërkesë për blerjen e tyre brenda afatit të përcaktuar më lart, ato kalojnë në publikim sipas procedurave të vendimi të Këshillit të Ministrave nr.159, datë 13.3.2003. Në këtë rast dega e AKP-së njofton dhe organet e rendit në prefekturë për automjetet ose mjetet e transportit që janë në procedurë privatizimi për t'i bllokuar ato deri në përfundimin e privatizimit të tyre. Me lidhjen e kontratës së shitblerjes, dega e AKP-së njofton organet përkatëse të rendit për transferimin e lejes së qarkullimit të automjetit tek pronari i ri, konform akteve normative në fuqi.

9. Në zbatim të pikës 4 kapitulli i III-të, punonjësit specialistë, farmacistë ose stomatologë, që kanë aktualisht kontratë qiraje për objektin, kanë të drejtën e parablerjes, sipas çmimit të përcaktuar në ankand, vetëm në rastet kur për këto objekte nuk ka pronarë trualli. Në rastin kur pronarët e truallit të objektit kanë paraqitur dokumentacionin përkatës të pronësisë dhe kërkesën për blerjen e objektit sipas pikës 8-të të këtij kapitulli, por nuk paraqiten në ankandin e objektit që ndodhet në pronën e tyre, komisioni i ankandit evidenton kërkesat për blerje në procesverbalin përkatës dhe cakton një datë tjetër për zhvillimin e tij brenda pesë ditëve nga data e zhvillimit të ankandit, duke njoftuar edhe një herë pronarët e truallit. Nëse edhe në këtë datë pronarët e truallit nuk paraqiten për blerjen e objektit, atëherë AKP-ja realizon shitjen me ankand të këtij objekti.

10. Në zbatim të pikës 5 kapitulli i III–të AKP-ja me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, si dhe me kërkesë të Ministrisë së Ekonomisë, mund të përdorë edhe forma të tjera publikimi në media televizive, postera etj. Shpenzimet e publikimit do të përballohen nga të ardhurat e privatizimit.

11. Shkresa përcjellëse e degës së shoqërive publike, e organeve të varësisë, që shoqëron dokumentacionin përkatës të vlerësimit duhet të përmbajë të specifikuar qartë: emërtimin e objektit, vendndodhjen e tij, sipërfaqen e përgjithshme dhe atë nënobjekt, vlerën gjithsej të objektit, e ndarë në vlerën e mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros, si dhe përmbajtjen e dokumentacionit të vlerësimit etj.; në të kundërt dokumentacioni i vlerësimit konsiderohet i parregullt.

12. Në pasqyrat e vlerësimit duhet të shënohet qartë në kolonën përkatëse indeksi i çmimit të përdorur, si dhe koeficienti i vendndodhjes së objektit.

13. Në zbatim të pikës 7 kapitulli i III-të, pjesëmarrësit në ankand në vendin, datën dhe orën e njoftuar duhet të paraqesin pranë komisionit të ankandit edhe dokumentin e identifikimit të tyre (letërnjoftimin, certifikatë me fotografi). Disa persona kanë të drejtën e paraqitjes për blerje të objektit së bashku me një kërkesë të vetme. Kjo kërkesë duhet të shoqërohet me dokumentin bankar që përmban emrat e personave që bashkohen në këtë blerje. Në rast të paraqitjes së një blerësi, personat e tjerë kërkues duhet të përfaqësohen me prokurë.

14. Në zbatim të pikës 10 paragrafi i II-të kapitulli i III-të, pas shpalljes së fituesit të ankandit për shitjen me rezervë, AKP-ja nënshkruan me fituesin e ankandit aktmarrëveshjen në të cilën pasqyrohen afati i likuidimit të objektit, vlera e kësteve që do të shlyhen dhe afatet e likuidimit të tyre, dorëzimi i objektit etj. Kjo aktmarrëveshje do të jetë pjesë përbërëse e kontratës së shitjes që do të lidhet për objektin.

*15. Shfuqizuar.*[1]

16. Në zbatim të pikës 14 kapitulli i III-të, juristi i AKP-së (që merr pjesë në ankand pa të drejtë vote) ka të drejtë të kërkojë me shkrim ndërprerjen ose pezullimin e ankandit, në rast se konstaton shkelje të rregullores së ankandit, si dhe të procedurave për zhvillimin e tij. Pretendimi i tij i nënshtrohet gjykimit dhe votimit të shumicës. Vendimmarrja për pezullimin ose jo të ankandit i paraqitet për miratim Drejtorit të Përgjithshëm të AKP-së. Në rast miratim pezullimi, vazhdimi i procedurave të zhvillimit të ankandit do të bëhet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AKP-së, jo më shumë se tri ditë.

17. Në zbatim të pikës 18 kapitulli i III-të personi që ka fituar të drejtën e blerjes për objektin dhe nuk paguan vlerën e plotë të tij brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së tij si fitues ankandi ose pronar trualli, humbet vlerën prej 20 për qind të paguar për pjesëmarrje në ankand, si dhe të drejtën për të marrë pjesë përsëri në ankandin që do të zhvillohet për rishitjen e objektit në fjalë.

18. Në zbatim të pikës 5, germa (a) kapitulli IV-t për rastet e privatizimit tërësor të ndërmarrjeve, të linjave të shërbimit dhe të prodhimit, të objekteve së bashku me makineritë, të pajisjeve, të mjeteve të xhiros etj. që janë pjesë përbërëse të objektit; objektet ndërtimore të veçanta, pasi të kenë kaluar të gjitha procedurat, do të kontrollohen nga Ministria e Ekonomisë dhe do të dërgohen në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit.

19. Makineritë dhe pajisjet, mjetet e transportit, mjetet e xhiros, që privatizohen të veçuara, pasi të kontrollohen nga dega e shoqërisë publike, do të përcillen direkt në degën e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit në prefekturën përkatëse.

20. Në zbatim të pikës 7 kapitulli IV, verifikimi i pronës që do të privatizohet bëhet nga përfaqësuesi i degës së shoqërive publike, drejtori ose likuidatori dhe përfaqësuesi i AKP-së menjëherë pas daljes së miratimit të privatizimit. Vlerësimet e bëra pasqyrohen në aktverifikim, i cili do të jetë pjesë përbërëse e dosjes së vlerësimit. AKP-ja pasi pranon dokumentet e vlerësimit të objektit duhet të bëjë marrjen në dorëzim të tij brenda 15 ditëve para se të fillojë publikimi për shitje.

21. Agjencia Kombëtare e Privatizimit, në përputhje me kërkesat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.159, datë 13.3.2003 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që

---

[1] *Pika 15 e udhëzimit nr.1, datë 9.5.2003, shfuqizohet me vendim të Këshillit të Ministrave nr.743, datë 6.11.2003.*

privatizohet, si dhe procedura e shitjes" dhe këtij udhëzimi për zbatimin e këtij vendimi ka të drejtë të hartojë dhe të miratojë rregulloren e brendshme për zhvillimin e ankandit, si dhe të nxjerrë urdhrat përkatëse në përputhje të legjislacionit në fuqi, për të rritur efikasitetin e privatizimit.

*22. Shfuqizuar.*[2]

23. Publikimi në gazetat me qarkullim kombëtar për objektin që do të privatizohet, përveç informacionit plotësues të përcaktuar nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit, përmban edhe tabelën me të dhënat sipas formatit si më poshtë:

| Nr. | Emërtimi i objektit | Vendndodhja | Vlera fillest.e ankandit (në lekë) | Mjete xhiroje (në lekë) | Sipërfaqe gjithsej e objektit (në m2) | Sipërfaqe nën objekt (në m2) | Vlera e truallit në (lekë) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | | | | | | |
| 2 | | | | | | | |
| … | | | | | | | |

24. Dokumentacionet e vlerësimit të objekteve, makinerive, pajisjeve etj. të cilat kanë mbaruar procedurën e privatizimit dhe rezultojnë të pashitura të kthehen në degët e shoqërive publike përkatëse dhe këto të fundit t'i kthejnë në ndërmarrje apo institucionin e varësisë administrative.

25. Në zbatim të pikës 10, kapitulli IV, shfuqizimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr.192, datë 20.3.1998 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet dhe procedura e shitjes" me ndryshimet përkatëse… nënkupton shfuqizimin edhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.283, datë 18.6.1999 "Për privatizimin e ndërmarrjeve që nuk janë shitur sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.192, datë 20.3.1998"; vendimit të Këshillit të Ministrave nr.284, datë 18.6.1999 "Për disa shtesa e ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.192, datë 20.3.1998"; vendimit të Këshillit të Ministrave nr.520, datë 14.11.1999 "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.192, datë 20.3.1998"; vendimit të Këshillit të Ministrave nr.606, datë 16.12.1999 "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.192, datë 20.3.1998, si dhe udhëzimi në zbatim të tyre.

26. Bashkëlidhur këtij udhëzimi janë pasqyrat e vlerësimit nr.1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.159, datë 13.3.2003, si dhe pasqyra e koeficientëve të vendndodhjes.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin e Fletores Zyrtare.

AGJENCIA KOMBËTARE E PRIVATIZIMITMINISTRIA E EKONOMISË
DREJTOR I PËRGJITHSHËM MINISTRI
**Zihni Beqiraj Arben Malaj**

Pjesë e vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.159, datë 13.3.2003, botuar në Fletoren Zyrtare nr.20.

| Vendndodhja e objekteve të paluajtshme | Shtesa | Pakësime |
|---|---|---|
| a) Në rrethet ose qytetet Tiranë, Berat, Durrës, Fier, Korçë, Lushnjë, Pogradec, Sarandë, Shkodër, Vlorë ose në qendrat e banuara turistike ku përfshihen zonat e përcaktuara nga vendimi i | | |

*[2] Pika 22 e udhëzimit nr.1, datë 9.5.2003, shfuqizohet me vendim të Këshillit të Ministrave nr.140, datë 18.3.2005.*

| | | |
|---|---|---|
| Këshillit të Ministrave nr.88, datë 1.3.1993 "Për miratimin e zonave që kanë përparësi në zhvillimin e turizmit". | | |
| - Zonat e thella malore joturistike | - | 30% |
| - Jashtë vijave kufizuese të qyteteve të mësipërme (pika a) | 15% | - |
| - Brenda vijave kufizuese të qyteteve të mësipërme (pika a), përveç pjesëve që përfshihen më poshtë | 50% | - |
| - Në rrugët kryesore dhe segmente rrugësh me trafik të dendur (Rr.K.S.T.D) të qyteteve Fier, Lushnjë, Berat, qendrat e banuara të përshkruara në pikën (a). | 60% | - |
| - Në Rr.K.S.Rr.T.D të qyteteve Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Elbasan, Korçë, Pogradec, Sarandë. | 70% | - |
| b) Në rrethet ose qytetet Delvinë, Gjirokastër, Kavajë, Krujë, Laç ose Lezhë. | | |
| - Në zonat e thella malore joturistike | | 50% |
| Brenda vijave kufizuese të qyteteve (pika b) | 35% | |
| - Jashtë vijave kufizuese të qyteteve të mësipërme (pika b) | | |
| - Rr.K.S.Rr.T.D të qyteteve të pikës b. | 50% | |
| c) Në rrethet ose qytetet e Devollit, Kolonjës, Mallakastrës, Peqinit, Tepelenës, Peshkopisë, Kukësit, e Përmetit dhe qytetet e qendrat e tjera me 10-20 mijë banorë. | | |
| - Në zonat e thella malore joturistike | - | 55% |
| - Jashtë vijave kufizuese të qyteteve e qendrave më sipër (pika c) | - | 20% |
| - Brenda vijave kufizuese të qyteteve e qendrave më sipër (pika c) | | |
| -Rr.K.S.Rr.T.D në qendrat e qendrat (pikës c) | 10% | - |
| d) Në rrethet ose qytetet Bulqizë, Gramsh, Has, Kuçovë, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tropojë e qendra të tjera nën 10 000 banorë. | | |
| -Në zonat e thella malore joturistike | - | 70% |
| -Jashtë vijave kufizuese të qyteteve e qendrave të mësipërme (pika d) | - | 25% |
| -Brenda vijave kufizuese të qyteteve e qendrave të mësipërme (pika d) | - | 20% |
| -Rr.K.S.Rr.T.D në qytet e qendra (pika d) | - | 15% |
| e) Në zonat e pikat doganore | 35% | - |

Ndërmarrja_____
Institucioni_____
Objekti_____

PASQYRA NR.1

Gjendja faktike e mjeteve kryesore dhe vlerësimi i tyre në kohën e përfundimit të vlerësimit

| Nr | Emërtimi | Vl.fillestare ndërtim, prodhim apo çmimi bler.sipas kontabilitetit ose vlerësimit të bërë nga komisioni i vlerësimit 000/lekë | Amortizimi për investimet në 000/lekë | Vlera e mbetur në 000/lekë | | Vlefta e korrigjuar me idenksine çmimeve | Vlera e korrigjuar me koeficientin e vend-ndodhjes | Sipërfaq.m2 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | V.fillestare minus amortizimin sipas kontabilitetit | Vlefta e llogaritur me grup ekspertësh | | | Gjithsej | Nga kjo nënobjekt |
| | a | b | c | ç | d | e | f | g | h |
| 1 | Ndërtesa gjithsej | | | | | | | | |
| 2 | Instal.Paji sje transmesioni | | | | | | | | |
| 3 | Makineri e pajisje energjetike | | | | | | | | |
| 4 | Makineri e pajisje pune | | | | | | | | |
| 5 | Instrumenta e vegla | | | | | | | | |
| 6 | Mjete transporti | | | | | | | | |
| 7 | Kafshë pune e prodhimi | | | | | | | | |
| 8 | Kultura drufrutore | | | | | | | | |
| 9 | Inventar ekonomik | | | | | | | | |
| 10 | Të tjera | | | | | | | | |
| | Shuma | | | | | | | | |
| 11 | Vlefta e tokës | | | | | | | | |
| | Totali | | | | | | | | |

Komisioni i vlerësimit

(_____)(_____)(_____)(_____)

Shënim: Kjo pasqyrë plotësohet nga komisioni i vlerësimit duke u mbështetur në dokumentacionin përkatës kontabël, llogaritjet e matjet e kryera prej tij në bazë të legjislacionit në fuqi, si dhe dokumenteve e procesverbaleve të tjera që shërbejnë për këtë qëllim.

Ndërmarrja_____
Institucioni_____
Objekti_____

PASQYRA NR. 2

Gjendja faktike dhe vlerësimi për çdo objekt në kohën e përfundimit të vlerësimit

| Emërtimi | Viti I | | Vl.fillestare e prodh. apo çmimit të blerjes sipas kontabilitetit ose vlerësimit të bërë nga komisioni i vlerësimit 000/lekë | Amortizimi sipas kontabilitetit për investimet në 000/lekë | Vlefta e mbetur në 000/lekë | | Vlefta e llogaritur me koeficie-ntin e çmimeve | Vlefta e llogaritur me koeficientin e vend-ndodhjes | Sip.m2 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Ndërtimit, prodhimit ose blerjes | Vënies në shfrytëzim | | | Vl.fillestare minus amortizimin sipas kontabilitetit | Vlefta e llogaritur me grup eksper-tësh | | | Gjithsej | Nga kjo nën objekt |
| a | b | c | ç | d | e | f | g | m | o | q |
| I.Vlefta e objektit | | | | | | | | | | |
| Nga këto: | | | | | | | | | | |
| 1.Mjete kryesore | | | | | | | | | | |
| a)Ndërtim montime | | | | | | | | | | |
| b)makineri pajisje | | | | | | | | | | |
| c)Inventar ekonomik | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ç)Të tjera | | | | | | | | | | |
| 2)Mjete xhiro | | | | | | | | | | |
| 3.Toka | | | | | | | | | | |
| Shuma | | | | | | | | | | |

Komisioni i vlerësimit

(_____)(_____)(_____)(_____)

Shënim: Kjo pasqyrë plotësohet nga komisioni i vlerësimit duke u mbështetur në dokumentacionin përkatës kontabël, llogaritjet e matjet e kryera prej tij në bazë të legjislacionit në fuqi, si dhe dokumenteve e procesverbaleve të tjera që shërbejnë për këtë qëllim.

Ndërmarrja_____
Institucioni_____
Objekti_____

PASQYRA NR.3

Gjendja faktike dhe vlerësimi i mjeteve të xhiros (pa likuiditetet në kohën e përfundimit të vlerësimit)

| Nr. | Emërtimi | Grupi A | Grupi B | Grupi C |
|---|---|---|---|---|
| | | Me vlerë aktuale kontabël jo më shumë se vlera në tregun aktual | Me vlerë kontabël në kohën e blerjes jo më shumë se vlera në tregun aktual | Me vlerë kontabël x koeficientin 0.1 |
| | a | b | c | d |

1. Lëndë të para e materiale kryesore
2. Materiale ndihmëse
3. Lëndë djegëse
4. Pjesë ndërrimi
5. Ambalazhe
6. Inventar i imët në depo
7. Inventar i imët në përdorim
8. Prodhim në proces
9. Produkte të gatshme në magazinë
10. Mallra

Shuma
Gjithsej:_____

Nga këto:

a) Stoqe
b) Me qarkullim të ngadalshëm

Komisioni i vlerësimit

(_____) (_____) (_____)(_____)

Shënim: Kjo pasqyrë plotësohet bazuar në llogaritë analitike të mjeteve zhbirues, dokumenteve e procesverbaleve përkatëse kontabël, inventarizimit fizik për çdo element të tyre, si dhe rivlerësimit me çmimet e liberalizuara të tregut të lirë duke i grupuar sipas pasqyrës së mësipërme.

Ndërmarrja_____
Institucioni_____
Objekti_____

PASQYRA NR.4

Gjendja financiare e ndërmarrjes ose institucionit që privatizohet në kohën e përfundimit të vlerësimit

| Të ardhurat | | | Detyrimet | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emërtimi i llogarive | Vlefta 000/lekë | Nr. | Emërtimi i llogarive | Vlefta 000/lekë |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | Shuma: | | | Shuma: | |

Komisioni i vlerësimit

(_____) (_____)
(_____)(_____)

Ndërmarrja_____
Institucioni_____
Objekti_____

PASQYRA NR.5

Gjendja faktike dhe vlerësimi i investimeve në proces, në momentin e përfundimit të vlerësimit

000/lekë

| Nr. | Emërtimi | Vlefta fillestare e ndërtimit, prodhimit ose çmimi i blerjes sipas situacionit e dokumenteve të tjera kontabël | | Vlefta e shitjes e llogaritur me koeficientin e vendndodhjes | Sipërfaqja | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Para korrigjimit | Pas korrigjimit me ind.e çmimit | | Gjithsej | Nën objekt |
| | a | b | c (b x indx) | ç (c+shtesë) | d | e |

1.Vlefta gjithsej
Nga këto:
1. Ndërtim montime
2. Makineri pajisje
3. Investime të tjera
4. Studime
5. Mjete xhiruese pranë objektit
6. Vlefta e tokës
Shuma:_____

Komisioni i vlerësimit

(_____) (_____) (_____) (_____)

Shënim: Të dhënat për plotësimin e kësaj pasqyre të merren nga situacioni i ndërtimit të objektit të dokumenteve e procesverbaleve përkatëse kontabël që vërtetojnë kryerjen e shpenzimeve, si dhe llogaritjet e matjet e bëra direkt nga komisioni i vlerësimit. Kolona “C” tregon vlerën fillestare të korrigjuar me indeksin e çmimeve të konsumit.

Ndërmarrja_____
Institucioni_____
Objekti_____

PASQYRA NR.6

Të dhënat ekonomiko-financiare të ndërmarrjes ose institucionit që privatizohet

| Nr. | Emërtimi | Njësia e matjes | Vitet | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paraardhës | Ekzistues | Parashikues |
| 1 | Sipërfaqja e objektit dhe ambienteve që disponon ndërmarrja | m2 | | | |
| 2 | Sipërfaqja e tokës e punuar | m2 | | | |
| 3 | Vëllimi i prodhimit industrial i shitur | 000/lekë | | | |
| 4 | Vëllimi i prodhimit bujqësor | 000/lekë | | | |
| 5 | Volumi i punimeve SMT | 000/lekë | | | |
| 6 | Volumi i riparim shërbimeve meremetimeve | 000/lekë | | | |
| 7 | Volumi i transportit të mallrave | 000/lekë | | | |
| 8 | Volumi i ndërtim monumenteve | 000/lekë | | | |
| 9 | Qarkullimi i mallrave gjithsej | 000/lekë | | | |
| 10 | Vëllimi i investimeve | 000/lekë | | | |
| 11 | Importi gjithsej (çmimi i blerjes) | 000/lekë | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 12 | Eksporti gjithsej (çmimi i shitjes) | 000/lekë | | | |
| 13 | Numri i punonjësve | 000/lekë | | | |
| 14 | Fondi i pagave | 000/lekë | | | |
| 15 | Fitimi gjithsej<br>Nga ky: i derdhur në buxhet | 000/lekë<br><br>000/lekë | | | |
| 16 | Humbje gjithsej | 000/lekë | | | |
| 17 | Gjendje financiare | 000/lekë | | | |

Komisioni i vlerësimit

(_____)(_____)(_____)(_____)

Shënim: Të dhënat për plotësimin e kësaj pasqyre të merren nga situacioni i ndërtimit të objektit të dokumenteve e procesverbaleve përkatëse kontabël që vërtetojnë kryerjen e shpenzimeve, si dhe llogaritjet e matjet e bëra direkt nga komisioni i vlerësimit. Kolona "C" tregon vlerën fillestare të korrigjuar me indeksin e çmimeve të konsumit.

Ndërmarrja_____

Institucioni_____

Objekti_____

PASQYRA NR.7

Disa tregues përmbledhës të ndërmarrjes ose të institucionit që do të privatizohet:

| Nr | Emërtimi | Njësia e matjes | Në kohën e përfundimit të vlerësimit | Vërejtjet |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Vlefta e shitjes së mjeteve kryesore | 000/lekë | | |
| 2 | Vlefta e shitjes së mjeteve xhiruese | 000/lekë | | |
| 3 | Vlefta e shitjes së investimeve në proces | 000/lekë | | |
| 4 | Shuma 1-2-3 | | | |
| 5 | Fitimi për një punonjës | | | |
| 6 | Humbja për një punonjës | | | |
| 7 | Kërkesat e paraqitura për privatizim | | | |
| | Nga këto: | | | |
| | - Blerje direkte | | | |
| | - Aksione | | | |
| | - Ankand | | | |
| 8 | Vlera e shitjes ose e dhënies me qira të tokës | | | |

Komisioni i vlerësimit

(_____) (_____)

(_____)(_____)